FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 196

Tiranë – E martë, 25 tetor 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 104, datë 5.10.2016	Për miratimin e rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre".....	21515
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 105, datë 5.10.2016	Për miratimin e rregullores "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre.....	21536
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 106, datë 5.10.2016	Për miratimin e "Sistemit raportues për shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre".....	21548
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 107, datë 5.10.2016	"Për disa shtesa në rregulloren "Për kërkesat minimale të sigurisë në ambientet ku kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare dhe për transportin e vlerave monetare"".....	21593

VENDIM
Nr. 104, datë 5.10.2016

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE"

Në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre", të nenit 1 pika 4, shkronja "b" dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet rregullorja "Për licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 11, datë 27.2.2002, e ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Gent Sejko

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve, kërkesave, afateve, dokumentacionit dhe procedurave për:

a) licencimin e shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë;

b) dhënien e miratimeve paraprake gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre;

c) detyrimet për njoftime në Bankën e Shqipërisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre;

d) përcaktimin e kritereve për organet e shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre;

e) riorganizimin juridik të shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë:

a) personat që kërkojnë të licencohen si shoqëri kursim-krediti apo Unione të shoqërive të kursim-kreditit;

b) shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3
Baza juridike

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre", i cili këtu e më poshtë në këtë rregullore do të quhet ligji "Për SHKK-të", si dhe të nenit 1, pika 4, shkronja "b" dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre", si dhe në akte të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "bashkim me përthithje" - është bashkimi i një ose më shumë SHKK-ve të përthithura, nëpërmjet transferimit të totalit të aktiveve dhe të pasiveve të SHKK-së/ve të përthithur/a te një SHKK tjetër ekzistuese, e quajtur SHKK përthithëse, në këmbim të kontributeve të kësaj SHKK-je;

b) "bashkim me krijim" - është bashkimi i dy ose më shumë SHKK-ve ekzistuese, për të themeluar një SHKK të re, tek e cila transferohen të gjitha aktivet dhe pasivet e SHKK-ve ekzistuese që bashkohen, në këmbim të kontributeve të SHKK-së së re;

c) "ndarje me krijim" - është ndarja e realizuar nëpërmjet transferimit të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të SHKK-së (ekzistuese), në dy ose më shumë SHKK të themeluara rishtazi (pritëse), ku SHKK-ja e ndarë vlerësohet e prishur pa likuidim;

d) "ndarje me përthithje" - është ndarja e realizuar nëpërmjet transferimit të të gjitha aktiveve apo pasiveve të SHKK-së (ekzistuese), në dy ose më shumë SHKK ekzistuese (pritëse), ku SHKK-ja e ndarë vlerësohet e prishur pa likuidim.

KREU II
LICENCIMI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT

Neni 5
Objekti i veprimtarisë së SHKK-së dhe kërkesa për kapitalin

1. SHKK-ja ka si objekt kryesor të veprimtarisë së saj pranimin e depozitave dhe dhënien e kredive ndaj anëtarëve të shoqërisë.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, me miratimin e Bankës së Shqipërisë, SHKK-ja mund të ushtrojë edhe një ose disa nga veprimtaritë financiare të mëposhtme:

a) të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;

b) këmbimin valutor;

c) qiranë financiare.

3. Asnjë person nuk mund të ushtrojë veprimtaritë e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, pa u licencuar nga Banka e Shqipërisë.

4. SHKK-së i lind e drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë, vetëm pasi pajiset me licencë nga Banka e Shqipërisë dhe me certifikatën e sigurimit të depozitave nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, sipas parashikimeve të ligjit nr. 53/2014 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

5. SHKK-ja nuk mund të lidhë marrëveshje me të tretët (outsourcing), për të transferuar ushtrimin e veprimtarive financiare, për të cilat është licencuar dhe/ose për ushtrimin e funksionit të kontrollit të brendshëm.

6. Shuma e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për t'u licencuar si SHKK dhe për të ushtruar veprimtaritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, është 5,000,000 (pesë milionë) lekë.

7. Nëse SHKK-ja kërkon të ushtrojë edhe të paktën një prej veprimtarive të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, kapitali fillestar minimal i kërkuar është 20,000,000 (njëzet milionë) lekë.

8. Çdo pagesë dhe/ose shtesë e kapitalit nga kontributet individuale të çdo anëtari dhe/ose fondet e donatorëve mbi vlerën 100,000 lekë, shoqërohet me paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të informacionit lidhur me burimin e krijimit të këtij kapitali, sipas dokumentacionit të përcaktuar në shkronjën "e" të pikës 2, të nenit 6 të kësaj rregulloreje.

9. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme lidhur me burimin e krijimit të kontributeve ose të fondeve që do të shërbejnë si kapital fillestar minimal ose si shtesë e mëvonshme e tij.

10. Pagesat dhe/ose shpenzimet për blerjen ose për marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës, nuk përfshihen në shumën e kapitalit fillestar minimal.

Neni 6
Kërkesa në lidhje me dokumentacionin e shoqërisë së kursim-kreditit

1. Kërkesa për licencim si SHKK bëhet me shkrim (sipas formularit nr. 1 të kësaj rregulloreje) nga anëtarët themelues ose nga administratori i SHKK-së, ose nga një person i autorizuar ligjërisht prej tyre (sipas formularit nr. 2 të kësaj rregulloreje).

2. Kërkesa shoqërohet nga formularët e plotësuar, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, si dhe dokumentacioni i mëposhtëm:

a) akti i themelimit të SHKK-së;

b) statuti i SHKK-së;

c) ekstrakti i regjistrit tregtar për regjistrimin e SHKK-së, i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në të cilin duhet të jenë përcaktuar edhe veprimtaritë për të cilat SHKK-ja kërkon të licencohet;

d) vërtetimi i ASD-së për plotësimin e kushteve lidhur me sigurimin e depozitave;

e) dokumentacioni për kapitalin dhe burimin e tij, për çdo pagesë mbi vlerën e përcaktuar në pikën 8 të nenit 5 të kësaj rregulloreje:

i) deklaratë noteriale e anëtarëve themelues se burimi i kapitalit fillestar të paguar të SHKK-së nuk

është hua, kredi ose paradhënie nga subjekte të treta;

ii) deklaratë noteriale e anëtarëve themelues mbi burimin e krijimit të kapitalit fillestar të paguar dhe për çdo shtesë të tij gjatë zhvillimit të veprimtarisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- për personat juridikë:

evidenca e burimit të krijimit të fondeve, e paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (raporti i audituesit ligjor ose shoqërisë së auditimit, bilanci kontabël vjetor, dhurata ose burime të tjera të destinuara për pagesën e kontributit në kapitalin e SHKK-së).

- për individët ose personat fizikë tregtarë:

evidenca e burimit të krijimit të fondeve, e paraqitur në një formë të pranueshme ligjore (blerje ose shitje, dhurata, paga, depozita monetare në banka, ose të tjera evidenca të burimit të fondeve) dhe certifikata e autoriteteve përkatëse fiskale shtetërore lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore; dhe

iii) vërtetim nga banka ose dega e bankës së huaj të licencuar nga Banka e Shqipërisë, që subjekti ka bllokuar, në një llogari pranë saj, shumën e kapitalit të kërkuar sipas pikave 6 ose 7 të nenit 5, të kësaj rregulloreje. Kjo shumë zhbllokohet nëpërmjet njoftimit të Bankës së Shqipërisë, në përfundim të procedurës së licencimit.

f) dokumentacioni për anëtarët themelues, në rastin kur ata janë persona juridikë ose persona fizikë tregtarë:

i) ekstrakti i regjistrimit në regjistrin tregtar dhe vërtetim nga organet e tatim-taksave, për shlyerjen e rregullt të detyrimeve fiskale.

g) dokumentacioni për anëtarët themelues, në rastin kur ata janë individë:

i) dokumenti i identifikimit (emër, mbiemër, kombësia, shtetësia) dhe adresa e saktë e vendbanimit.

h) planbiznesi i veprimtarisë së propozuar (sipas përmbajtjes së formularit nr. 7 të kësaj rregulloreje).

i) aktet e brendshme rregullative (rregulloret dhe/ose udhëzimet e brendshme), të miratuara nga organet vendimmarrëse për:

- veprimtarinë operacionale të SHKK-së;

- sistemin e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedura efektive administrative të kontrollit të brendshëm;

- transparencën me anëtarin/anëtarët;

- administrimin e rreziqeve;

- parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, duke përfshirë një program masash, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

- organizimin, funksionimin dhe administrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë mënyrën e mbrojtjes/sigurisë së informacionit dhe të dhënave të anëtarëve.

j) informacioni mbi plotësimin e kushteve administrative dhe teknike të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive me sportel.

3. Dokumentacioni sipas pikës 2 të këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja, të ndryshme nga Republika e Shqipërisë, dokumentacioni duhet të jetë edhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.

4. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur, ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 7

Procedurat dhe afatet për shqyrtimin e kërkesës për licencim

1. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon dhënien e licencës si SHKK, brenda 3 (tre) muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë. Data e pranimit të kërkesës për licencë i njoftohet me shkrim SHKK-së, nga Banka e Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë, në rastet kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë dhe/b ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në ligjin për SHKK-të dhe në këtë rregullore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune, njofton SHKK-në për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e ligjit për SHKK-të dhe të kësaj rregulloreje, së bashku me kërkesën për informacion ose dokumentacion shtesë.

3. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për licencë, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga SHKK-ja brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për licencë, si dhe njofton me shkrim SHKK-në.

4. Banka e Shqipërisë, kur e gjykon të nevojshme, mund të kryejë verifikime në vend për vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur.

5. Banka e Shqipërisë mund të inspektojë mjediset/zyrat ku do të zhvillohet veprimtaria financiare, me qëllim verifikimin e plotësimit të kushteve teknike dhe të sigurisë për ushtrimin e këtyre veprimtarive, në zbatim të akteve nënligjore të miratuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 8
Dhënia ose refuzimi i licencës

1. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon licencën sipas përcaktimeve të nenit 72 të ligjit për SHKK-të.

2. Banka e Shqipërisë, përveç shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, bashkëpunon dhe kërkon informacion nga autoritetet mbikëqyrëse homologe dhe institucionet e specializuara për luftën kundër krimit ekonomik, parandalimin e pastrimit të parave, organet e tatim-taksave, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Autoritetin e Konkurrencës etj.

3. Banka e Shqipërisë, brenda 15 (pesë-mbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit sipas pikës 1 të këtij neni, i njofton SHKK-së vendimin për dhënien e licencës ose për refuzimin e saj, të shoqëruar me arsyet përkatëse.

Neni 9
Karakteristikat e licencës

1. Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.

2. Licenca e SHKK-së përfshin emërtimin e subjektit (sipas përcaktimeve në ligjin për SHKK-të), numrin dhe datën e lëshimit të saj, si edhe ka si pjesë përbërëse të saj aneksin e veprimtarive financiare, për të cilat SHKK-ja licencohet.

Neni 10
Botimi i vendimit për dhënien e licencës

1. Banka e Shqipërisë publikon vendimin për dhënien e licencës SHKK-së, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Neni 11
Komisionet

1. SHKK-ja që aplikon për marrjen e licencës, paguan një komision për përpunimin e kërkesës për licencë prej 10,000 (dhjetë mijë) lekësh në Bankën e Shqipërisë, në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit përkatës.

2. Komisioni, i përcaktuar në këtë nen, nuk rimbursohet edhe në rast të refuzimit të dhënies së licencës nga Banka e Shqipërisë.

Neni 12
Revokimi i licencës

1. Banka e Shqipërisë revokon licencën e SHKK-së, në rastet kur:

a) vendos dhënien e miratimit për fillimin e likuidimit vullnetar të SHKK-së;

b) vendos SHKK-në në likuidim të detyruar.

2. Vendimi për revokimin e licencës i komunikohet menjëherë me shkrim SHKK-së, duke dhënë dhe arsyet përkatëse. Ky vendim i njoftohet edhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

3. Vendimi i revokimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë.

4. SHKK-ja ndalohet të kryejë veprimtaritë e parashikuara në licencën e saj, pas hyrjes në fuqi të vendimit të Bankës së Shqipërisë për revokimin e saj.

5. Banka e Shqipërisë e publikon vendimin për revokimin e licencës për të vepruar si shoqëri kursim-krediti, në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

6. SHKK-ja së cilës i është revokuar licenca, është e detyruar që të depozitojë licencën e revokuar pranë Bankës së Shqipërisë.

KREU III
ORGANET E SHKK-SË

Neni 13
Kriteret e emërimit të anëtarëve të këshillit drejtues, administratorit dhe anëtarëve të komitetit të kontrollit

1. Kryetari i këshillit drejtues dhe më shumë se gjysma e anëtarëve të këshillit drejtues, si dhe administratori i SHKK-së, përveç sa parashikohet në nenin 19 të ligjit për SHKK-të, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të zotërojnë diplomë universitare;

b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se 3 (tre) vjet në fushën financiare;

c) të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional.

2. Në rastin e Unionit, kriteret e emërimit të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë të

zbatueshme për të gjithë anëtarët e këshillit drejtues dhe për administratorin e Unionit.

3. Anëtarët e komitetit të kontrollit, përveç sa parashikohet në nenin 31 të ligjit për SHKK-të, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të zotërojnë diplomë universitare në ekonomi;

b) të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional.

4. Anëtarët e tjerë të këshillit drejtues që nuk përfshihen në pikën 1 të këtij neni, përveç sa parashikohet në nenin 19 të ligjit për SHKK-të, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të kenë kryer arsimin e mesëm;

b) të kenë përvojë pune jo më pak se 3 (tre) vjet;

c) të kenë reputacion të lartë etik dhe profesional.

5. Anëtarët e këshillit drejtues, anëtarët e komitetit të kontrollit, dhe administratori i SHKK-së, nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht funksione edhe në organet drejtuese të një SHKK-je tjetër ose të një Unioni.

Neni 14

Dokumentacioni për miratimin paraprak të kryetarit të këshillit drejtues, administratorit dhe kryetarit të komitetit të kontrollit

1. SHKK-ja paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë, për marrjen e miratimit paraprak për kryetarin e këshillit drejtues, administratorin dhe për kryetarin e komitetit të kontrollit, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimi i organit kompetent, për emërimin e personit në organet drejtuese;

b) dokumenti i identifikimit;

c) diploma e arsimit sipas kërkesave të kësaj rregulloreje;

d) CV-ja e nënshkruar (sipas formularit nr. 9 të kësaj rregulloreje);

e) të paktën një rekomandim lidhur me aftësinë profesionale, të lëshuar nga eprorë ose punëdhënës të mëparshëm;

f) një përshkrim të detajuar të punës, për pozicionin që do të mbajë personi i propozuar;

g) deklaratë personale në lidhje me shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore;

h) vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente, që certifikojnë se:

i) personi nuk është në ndjekje penale;

ii) personi nuk është në gjykim për vepra penale;

iii) personi nuk është i dënuar penalisht (nga Ministria e Drejtësisë);

iv) personi nuk është objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm (nga Zyra e Përmbarimit Gjyqësor).

Dokumentet e lartpërmendura në shkronjën "h", duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

2. Në rastin kur individi i propozuar është shtetas i huaj, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, paraqet në Bankën e Shqipërisë edhe lejen e tij të qëndrimit dhe të punës, në bazë dhe për zbatim të ligjit "Për të huajt".

3. Dokumentacioni i përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse të shteteve të huaja, dokumentacioni duhet të jetë edhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.

4. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur, ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 15

Dokumentacioni për anëtarët e tjerë të organeve drejtuese të SHKK-së

SHKK-ja mban në dosje të veçanta dokumentacionin sipas përcaktimeve në nenin 14 të kësaj rregulloreje, për anëtarët e tjerë të këshillit drejtues dhe të komitetit të kontrollit, që nuk miratohen nga Banka e Shqipërisë.

KREU IV

MIRATIMET PARAPRAKE DHE DETYRIMI PËR NJOFTIM

Neni 16

Miratimet paraprake

1. Shoqëria e kursim-kreditit, pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, nuk mund të:

a) ushtrojë veprimtari financiare të papërfshira në licencën e dhënë;

b) të emërojë kryetarin e këshillit drejtues, administratorin dhe kryetarin e komitetit të kontrollit.

2. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon miratimin paraprak, sipas pikës 1 të këtij neni, brenda 3 (tre) muajve nga paraqitja e plotë e kërkesës, mbështetur

në dokumentacionin e përcaktuar në nenin 17 të kësaj rregulloreje.

3. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratimin paraprak, sipas pikës 1 të këtij neni, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar nuk plotësohen nga SHKK-ja brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar, si dhe njofton me shkrim SHKK-në.

Neni 17
Kërkesa në lidhje me dokumentacionin për miratimet paraprake

1. SHKK-ja, për të marrë miratimet paraprake të parashikuara në pikën 1 të nenit 16 të kësaj rregulloreje, paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) për veprimtaritë shtesë:

i) vendimi i organit vendimmarrës të SHKK-së për ushtrimin e veprimtarisë shtesë;

ii) ekstrakti i Regjistrit Tregtar, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në të cilin të jetë përcaktuar dhe veprimtaria shtesë në objektin e SHKK-së, si dhe shuma e kapitalit fillestar minimal, të paguar sipas përcaktimit të pikës 7 të nenit 5 të kësaj rregulloreje;

iii) informacioni mbi plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë, në ambientet në të cilat do të kryhet veprimtaria shtesë, në rast se kjo veprimtari realizohet me sportel;

iv) rregulloret dhe/ose manualet e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë shtesë;

v) parashikimin për 3 (tre) vitet e ardhshme të treguesve financiarë për veprimtarinë/të shtesë dhe ndikimin e tyre në gjendjen e përgjithshme financiare të SHKK-së, si dhe pasqyrat financiare (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital), sipas formularëve nr. 3, 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje.

b) për miratimin e kryetarit të këshillit drejtues, të administratorit dhe të kryetarit të komitetit të kontrollit, paraqet dokumentacionin e parashikuar në nenin 14 të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë, sipas rastit, mund të kërkojë edhe dokumente shtesë, përveç sa është parashikuar në këtë nen.

3. Dokumentacioni sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar.

4. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur, ose dërgohet me postë të regjistruar.

5. Banka e Shqipërisë, në rastin e refuzimit të kërkesës për të ushtruar veprimtari shtesë, jep me shkrim arsyet e këtij refuzimi.

Neni 18
Detyrimet për njoftim

1. SHKK-ja njofton Bankën e Shqipërisë në të gjitha rastet dhe sipas afateve të përcaktuara në nenin 75 të ligjit për SHKK-të.

2. SHKK-ja, përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, njofton Bankën e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve, për:

a) zmadhimin e kapitalit, si pasojë e kontributit individual të çdo anëtari dhe/ose fondeve të donatorëve, mbi vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë;

b) zvogëlimin e kapitalit mbi vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë;

c) ndryshimet në strukturën organizative;

d) hapjen ose mbylljen e degëve të SHKK-së, apo ndryshime të adresës së tyre;

e) largimin/emërimin e anëtarëve të këshillit drejtues, administratorit dhe anëtarëve të komitetit të kontrollit, sipas formularit nr. 8 të kësaj rregulloreje.

KREU V
LICENCIMI I UNIONIT

Neni 19
Veprimtaritë financiare dhe kërkesa për kapitalin

1. Unioni licencohet për të ushtruar veprimtarinë e pranimit të depozitave dhe dhënies së kredive, vetëm për anëtarët e Unionit.

2. Unioni, përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, mund kryejë për anëtarët e tij edhe funksionet e parashikuara në nenin 45, pika 2 të ligjit për SHKK-të.

3. Unionit i lind e drejta për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë, vetëm pasi pajiset me licencë nga Banka e Shqipërisë dhe me certifikatën e sigurimit të depozitave nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave, sipas parashikimeve të ligjit nr. 53/2014 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar.

4. Unioni nuk mund të lidhë marrëveshje me të tretët (outsourcing), për të transferuar ushtrimin e veprimtarive financiare për të cilat është licencuar

dhe/ose për ushtrimin e funksionit të kontrollit të brendshëm.

5. Shuma e kapitalit fillestar minimal të kërkuar për t'u licencuar si Union i shoqërive të kursim-kreditit dhe për të ushtruar veprimtaritë financiare të përcaktuara në ligjin për SHKK-të, është 20,000,000 (njëzet milionë) lekë.

6. Çdo shtesë e kapitalit, si dhe çdo ndryshim në strukturën e tij, shoqërohet me paraqitjen në Bankën e Shqipërisë të informacionit lidhur me burimin e krijimit të këtij kapitali, sipas dokumentacionit të përcaktuar në shkronjën "e" të pikës 2 të nenit 6 të kësaj rregulloreje.

7. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime të mëtejshme, lidhur me burimin e krijimit të kontributeve ose të fondeve, që do të shërbejnë si kapital fillestar minimal ose si shtesë e mëvonshme e tij.

8. Pagesat dhe/ose shpenzimet për blerjen ose për marrjen me qira të lokaleve dhe të pajisjeve të punës nuk përfshihen në shumën e kapitalit fillestar minimal.

Neni 20

Dokumentacioni dhe procedura e licencimit të Unionit

1. Kërkesa për licencimin e Unionit bëhet me shkrim (sipas formularit nr. 1 të kësaj rregulloreje) nga anëtarët, ose administratori i Unionit, ose nga një person i autorizuar ligjërisht prej tyre (sipas formularit nr. 2 të kësaj rregulloreje).

2. Kërkesa shoqërohet nga formularët e plotësuar, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, si dhe dokumentacioni i mëposhtëm:

a) akti i themelimit të Unionit;

b) statuti i Unionit;

c) vendimet e asambleve të SHKK-ve themeluese të Unionit për pjesëmarrjen në Union;

d) ekstrakti i regjistrit tregtar për regjistrimin e Unionit, i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në të cilin të jenë përcaktuar edhe veprimtaritë për të cilat Unioni kërkon të licencohet;

e) dokumentacioni për burimin e kapitalit sipas shkronjës "e" të pikës 2 të nenit 6 të kësaj rregulloreje;

f) planbiznesi i veprimtarisë së propozuar (sipas përmbajtjes së formularit nr. 7 të kësaj rregulloreje);

g) aktet e brendshme rregullative (rregulloret dhe/ose udhëzimet e brendshme), të miratuara nga organet vendimmarrëse për:

i) veprimtarinë operacionale të Unionit;

ii) sistemin e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedura efektive administrative të kontrollit të brendshëm;

iii) transparencën me anëtarët e Unionit;

iv) administrimin e rreziqeve;

v) parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, duke përfshirë një program masash në përputhje me legjislacionin në fuqi;

vi) organizimin, funksionimin dhe administrimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë mënyrën e mbrojtjes/ sigurisë së informacionit dhe të dhënave të anëtarëve.

h) informacioni mbi plotësimin e kushteve administrative dhe teknike të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive me sportel.

3. Dokumentacioni sipas pikës 2 të këtij neni duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse në shtete të huaja, të ndryshme nga Republika e Shqipërisë, dokumentacioni duhet të jetë edhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.

4. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur, ose dërgohet me postë të regjistruar.

5. Për licencimin e Unionit zbatohen kërkesat e neneve 7, 8, 9, 10, 12, 13, 14 dhe 15 të kësaj rregulloreje.

Neni 21

Komisionet

1. Unioni që aplikon për marrjen e licencës, paguan një komision për përpunimin e kërkesës për licencë prej 30,000 (tridhjetë mijë) lekësh në Bankën e Shqipërisë, në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit përkatës.

2. Komisioni nuk rimbursohet, edhe në rastet e refuzimit të dhënies së licencës nga Banka e Shqipërisë.

Neni 22

Miratimet paraprake dhe njoftimet

1. Unioni, pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë, nuk mund:

a) të krijojë një njësi organizative të veçantë përgjegjëse për monitorimin e SHKK-ve;

b) të emërojë drejtuesin e njësisë organizative të përcaktuar në shkronjën "a" të kësaj pike.

2. Dokumentacioni për miratimet paraprake të parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, përcaktohet në nenet 23 dhe 24 të kësaj rregulloreje.

3. Banka e Shqipërisë jep ose refuzon miratimet paraprake, sipas pikës 1 të këtij neni, brenda 3 (tre) muajve nga paraqitja e plotë e kërkesës.

4. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratimin paraprak, sipas pikës 1 të këtij neni, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar nuk plotësohet nga Unioni brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar, si dhe njofton me shkrim Unionin.

5. Unioni njofton Bankën e Shqipërisë në të gjitha rastet dhe sipas afateve të përcaktuara në nenin 75 të ligjit për SHKK-të.

6. Unioni, përveç sa parashikohet në pikën 5 të këtij neni, njofton Bankën e Shqipërisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve, për:

a) zmadhimin e kapitalit;

b) zvogëlimin e kapitalit;

c) ndryshimet në strukturën e kapitalit;

d) ndryshime në strukturën organizative;

e) hapjen ose mbylljen e degëve të Unionit, apo ndryshime të adresës së tyre;

f) largimin/emërimin e administratorit, të anëtarëve të këshillit drejtues dhe të komitetit të kontrollit dhe të drejtuesit të njësisë së monitorimit, sipas formularit nr. 8 të kësaj rregulloreje.

Neni 23

Njësia organizative përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit

1. Njësia përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit është njësi organizative e veçantë e Unionit, e pavarur nga veprimtaritë, strukturat dhe personat që ajo monitoron.

2. Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak, kur krijon bindjen se struktura dhe buxheti i njësisë përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit janë në përputhje me numrin, përmasat dhe rreziqet e SHKK-ve të cilat monitoron.

3. Unioni paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë për marrjen e miratimit paraprak për njësinë përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimin e organit kompetent për krijimin e kësaj njësie;

b) strukturën e njësisë organizative që propozohet të krijohet;

c) parashikimin e numrit të punonjësve, buxhetin e planifikuar dhe SHKK-të që do të monitorohen;

d) rregulloret e funksionimit të njësisë, ku të parashikohen edhe linjat e raportimit të saj.

Neni 24

Drejtuesi i njësisë organizative përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit

1. Drejtuesi i njësisë përgjegjëse për monitorimin e SHKK-ve, plotëson kriteret e mëposhtme:

a) zotëron diplomë universitare, ose minimalisht ka kryer programin e ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë në ekonomi;

b) ka përvojë prej të paktën 5 (pesë) vjet në sektorin bankar dhe/ose financiar;

c) ka reputacion të lartë etik dhe profesional;

d) ka përvojë të përshtatshme dhe të mjaftueshme në drejtim (të paktën 3-vjeçare në sistemin bankar dhe/ose financiar).

2. Unioni paraqet një kërkesë me shkrim pranë Bankës së Shqipërisë për marrjen e miratimit paraprak për drejtuesin e njësisë organizative përgjegjëse për ushtrimin e monitorimit ndaj SHKK-ve, të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimi i organit kompetent mbi propozimin për emërimin e drejtuesit përkatës;

b) dokumenti i identifikimit;

c) diploma e arsimit të lartë;

d) CV-ja e nënshkruar (sipas formularit nr. 9 të kësaj rregulloreje);

e) të paktën një rekomandim lidhur me aftësinë profesionale, të lëshuar nga eprorë, punëdhënës të mëparshëm apo akademikë;

f) një përshkrim të detajuar të punës për drejtuesin e propozuar;

g) deklaratë personale në lidhje me shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore;

h) vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente, që certifikojnë se:

i) personi nuk është në ndjekje penale;

ii) personi nuk është në gjykim për vepra penale;

iii) personi nuk është i dënuar penalisht (nga Ministria e Drejtësisë);

iv) personi nuk është objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm (nga Zyra e Përmbarimit Gjyqësor).

Dokumentet e lartpërmendura në shkronjën "h", duhet të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Unioni, në rastin kur individi i propozuar për drejtues është një shtetas i huaj, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, paraqet në Bankën e Shqipërisë edhe lejen e tij të qëndrimit dhe të punës, në bazë dhe për zbatim të ligjit "Për të huajt".

4. Dokumentacioni i përcaktuar sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet zyrtare përkatëse të shteteve të huaja, dokumentacioni duhet të jetë edhe i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse.

5. Dokumentacioni dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur, ose dërgohet me postë të regjistruar.

KREU VI
RIORGANIZIMI JURIDIK I SHKK-ve DHE UNIONEVE TË TYRE

Neni 25
Bashkimi me përthithje

1. SHKK-ja nuk mund të riorganizohet, nëpërmjet bashkimit me përthithje, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për miratim bëhet me shkrim nga SHKK-ja përthithëse dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së përgjithshme të secilës SHKK të përfshirë në procesin e bashkimit, për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit me përthithje;

b) marrëveshja/projekti i bashkimit me përthithje, i nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të SHKK-ve që marrin pjesë në bashkim;

c) bilanci i SHKK-së përthithëse dhe të dhëna të detajuara për kapitalin, të përgatitura mbi baza të konsoliduara dhe të certifikuara nga një auditues ligjor ose shoqëri auditimi;

d) projektstatuti i SHKK-së, pas realizimit të procesit të bashkimit me përthithje;

e) plani strategjik për realizimin e përthithjes për SHKK-në përthithëse, i shoqëruar me pasqyrat financiare (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital), sipas formularëve nr. 3, 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje dhe me parashikimet në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës për tre vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë;

f) nëse do të ketë ndryshime në strukturën organizative të SHKK-së përthithëse, struktura e re organizative si dhe numri i mundshëm i punonjësve.

Neni 26
Bashkimi me krijim

1. SHKK-ja nuk mund të riorganizohet, nëpërmjet bashkimit me krijim, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për miratim bëhet me shkrim nga SHKK-të ekzistuese dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së përgjithshme të secilës SHKK të përfshirë në procesin e bashkimit, për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit me krijim;

b) marrëveshja/projekti i bashkimit me krijim, i nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të SHKK-ve që marrin pjesë në bashkim;

c) bilanci i SHKK-së së re, me të dhëna të detajuara për kapitalin, të përgatitura mbi baza të konsoliduara dhe të certifikuara nga një auditues ligjor ose shoqëri auditimi.

Neni 27
Ndarja me përthithje

1. SHKK-ja nuk mund të riorganizohet nëpërmjet ndarjes me përthithje pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për miratim bëhet me shkrim nga SHKK-ja që ndahet dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së përgjithshme të secilës SHKK të përfshirë në procesin e ndarjes, për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet ndarjes me përthithje;

b) marrëveshja/projekti i ndarjes me përthithje, i nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të SHKK-ve të përfshira në ndarjen me përthithje;

c) bilancet e SHKK-së që ndahet dhe të SHKK-ve pritëse me të dhëna të detajuara të kapitalit. Bilancet përgatiten mbi baza të konsoliduara dhe certifikohen nga një auditues ligjor ose shoqëri auditimi;

d) plani strategjik për realizimin e ndarjes për SHKK-të pritëse, i shoqëruar me pasqyrat financiare (bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital) sipas formularëve nr. 3, 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje, dhe me parashikimet në lidhje me zbatimin e kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës për tre vitet e para të ushtrimit të veprimtarisë;

e) struktura e re organizative e SHKK-ve pritëse dhe numri i mundshëm i punonjësve.

Neni 28
Ndarja me krijim

1. SHKK-ja nuk mund të riorganizohet, nëpërmjet ndarjes me krijim, pa miratimin paraprak të Bankës së Shqipërisë.

2. Kërkesa për miratim bëhet me shkrim nga SHKK-ja që po ndahet dhe shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së përgjithshme të SHKK-së që po ndahet, për miratimin e riorganizimit nëpërmjet ndarjes me krijim;

b) marrëveshja/projekti i ndarjes me krijim, i nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të SHKK-ve, të përfshira në ndarjen me krijim;

c) bilancet e SHKK-ve të reja pritëse me të dhëna të detajuara mbi kapitalin të certifikuara nga një auditues ligjor ose shoqëri auditimi;

d) nëse kapitali i SHKK-së që ndahet nuk plotëson minimumin e kapitalit fillestar të kërkuar për SHKK-të pritëse, që përfitohen nga procesi i ndarjes, depozitohen fonde të nevojshme shtesë në një llogari bankare.

Neni 29
Të përgjithshme për bashkimin dhe ndarjen

1. Në rastet kur bashkimet dhe ndarjet çojnë në krijimin e, të paktën, një SHKK-je të re, kjo e fundit do t'u nënshtrohet të gjitha rregullave të përcaktuara në këtë rregullore, për licencimin rishtazi si SHKK.

2. Banka e Shqipërisë përveç dokumentacionit të përcaktuar në këtë rregullore, mund të kërkojë, rast pas rasti, edhe informacione të tjera shtesë, të cilat i gjykon të nevojshme në procesin e vendimmarrjes, nisur nga veçoritë (specifikat) e këtij procesi.

3. Banka e Shqipërisë, pasi shqyrton dhe verifikon dokumentacionin e paraqitur, merr vendimin për miratimin ose refuzimin e riorganizimit të SHKK-së.

4. Afati maksimal për shqyrtimin e dokumentacionit dhe për miratimin ose për refuzimin e bashkimit/ndarjes, është 3 (tre) muaj nga depozitimi i dokumentacionit të plotë, sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

5. Në rastin e bashkimit me përthithje, SHKK-ja përthithëse vazhdon të ushtrojë vetëm veprimtaritë financiare për të cilat është licencuar.

6. Në rastin e ndarjes me përthithje, SHKK-të pritëse vazhdojnë të ushtrojnë vetëm veprimtaritë financiare për të cilat janë licencuar.

Neni 30
Shndërrimi i Unionit në SHKK

1. Unioni mund të shndërrohet në formën e një SHKK-je, pas miratimit të Bankës së Shqipërisë, në përputhje më parashikimet e kreut IX të ligjit për SHKK-të.

2. Banka e Shqipërisë jep miratimin, nëse plotësohen kërkesat e nenit 55 dhe të nenit 56 (kërkesat për dokumentacion) të ligjit për SHKK-të.

3. Raporti mbi realizimin e shndërrimit të Unionit në SHKK, pjesë e dokumentacionit të parashikuar në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 56 të ligjit për SHKK-të, hartohet nga një shoqëri auditimi, e cila duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë person juridik i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë për ushtrimin e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë;

b) të ketë 3 (tre) vjet eksperiencë në fushën e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të bankave ose subjekteve të tjera financiare, që mbajnë kontabilitetin sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-ve);

c) të paktën dy prej ortakëve ose të punësuarve të shoqërisë, të kenë titull profesional "auditues ligjor";

d) të mos ketë konflikt interesash me Unionin, sipas përcaktimeve të ligjit "Për auditimin ligjor".

Neni 31
Përfundimi i anëtarësisë së SHKK-së në Union

1. Në rastin e përfundimit të anëtarësisë së SHKK-së në Union, SHKK-ja që do të përfundojë anëtarësinë dhe Unioni, caktojnë një shoqëri auditimi e cila do të hartojë bilancet e SHKK-së dhe të Unionit para dhe pas përfundimit të anëtarësisë në Union, me të dhëna të detajuara të kapitalit.

2. SHKK-ja, e cila do të përfundojë anëtarësinë, paraqet në Bankën e Shqipërisë vendimin e asamblesë së përgjithshme të SHKK-së, për përfundimin e anëtarësisë në Union.

3. SHKK-ja që do të përfundojë anëtarësinë dhe Unioni, paraqesin në Bankën e Shqipërisë bilancet e hartuara nga shoqëria e auditimit, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Banka e Shqipërisë, mund të paralajmërojë SHKK-në, e cila do të përfundojë anëtarësinë në Union, në rast se ky veprim mund të sjellë pasoja negative për SHKK-në.

KREU VII
LIKUIDATORI

Neni 32
Kushtet kualifikuese të likuidatorit

1. Banka e Shqipërisë vendos në likuidim të detyruar SHKK-në, kur konstaton ekzistencën e një ose më shumë prej kushteve, të parashikuara në nenin 95 të ligjit për SHKK-të.

2. Procesi i likuidimit të detyruar kryhet nga likuidatori i caktuar nga Banka e Shqipërisë.

3. Personi i propozuar për likuidator, për të ushtruar funksionin e likuidatorit, sipas dispozitave të ligjit për SHKK-të, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të përmbushë kushtet e përcaktuara në ligjin për SHKK-të dhe në aktet nënligjore, të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për administratorët e SHKK-së;

b) të ketë përvojë pune të paktën 5-vjeçare, si drejtues ekzekutiv në një institucion financiar ose bankë, apo në një shoqëri auditimi.

4. Personi i propozuar si likuidator i SHKK-së, përpara emërimit të tij, depoziton një vërtetim, në të cilin shprehet se ndaj tij nuk ka ndonjë ndalesë të përmendur në nenin 33 të kësaj rregulloreje.

Neni 33
Kushtet skualifikuese të likuidatorit

1. Një individ nuk është i përshtatshëm për të ushtruar funksionin e likuidatorit ose lirohet nga ky funksion, në rastet kur:

a) është dënuar penalisht nga gjykata për një vepër penale, për të cilën ligji parashikon dënimin me burgim;

b) në çastin e emërimit të tij, ka dyshime të bazuara për pjesëmarrje të tij në veprimtari mashtruese, apo i kërkohet dëmshpërblim që mund të privojë ose të cenojë materialisht mundësitë e tij për të realizuar detyrën;

c) është subjekt i hetimeve për veprimtari mashtruese ose vepra të tjera penale;

ç) me vendim të gjykatës, është në pamundësi për të ushtruar detyrat ndaj SHKK-së;

d) ka konflikt interesi me SHKK-në, sipas nenit 33 të ligjit për SHKK-të.

KREU VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 34
Masat mbikëqyrëse dhe sanksionet

Banka e Shqipërisë në rast të shkeljes së dispozitave të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse dhe/ose gjobat e parashikuara në ligjin për SHKK-të.

Neni 35
Dispozita kalimtare

1. SHKK-të dhe Unionet e licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe që ushtrojnë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, marrin masa për organizimin e veprimtarisë dhe strukturës së brendshme, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, brenda datës 30 qershor 2017.

2. SHKK-të dhe Unionet e licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe që ushtrojnë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, marrin masa për plotësimin e niveleve minimale të kërkuara të kapitalit, siç përcaktohet në nenet 5 dhe 19 të kësaj rregulloreje, brenda datës 30 qershor 2018.

3. Banka e Shqipërisë ka të drejtë t'u kërkojë SHKK-ve dhe Unioneve të licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, informacione shtesë në zbatim të dispozitave të ligjit për SHKK-të, në rastet që e gjykon të arsyeshme.

Neni 36
Të fundit

Formularët bashkëlidhur janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

FORMULARI NR. 1

KËRKESË DREJTUAR BANKËS SË SHQIPËRISË PËR DHËNIE LICENCE PËR SHOQËRI KURSIM-KREDITI/ UNION TË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT

Emri i SHKK-së/Unionit: _____
Vendndodhja e propozuar : Adresa _____, Shqipëri
(Qyteti) (Rrethi)

Me anë të kësaj kërkese i drejtohemi Bankës së Shqipërisë, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me licencë për të kryer veprimtari si shoqëri kursim-krediti/Union:

- pranimin e depozitave dhe dhënien e kredive; ☐
- të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave; ☐
- këmbimin valutor; ☐
- qiranë financiare ☐

Në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë, angazhohemi për zbatimin e ligjit "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre" dhe të legjislacionit shqiptar.

Kërkuesit:
_____
_____
_____

Shënim: Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të kësaj rregulloreje dërgohen në adresën e mëposhtme:

Departamenti i Mbikëqyrjes
Banka e Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej", Nr.1
Tiranë, Shqipëri.

FORMULARI NR. 2

VENDIMI

I ----------

(ORGANIT VENDIMMARRËS)

PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE

---------- (Organi vendimmarrës) vërteton që, me sa dimë e besojmë, informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i vërtetë dhe i plotë. Për më tepër, ---------- (organi vendimmarrës) emëron dhe përcakton si përfaqësues:

_____

(Emri) (Atësia) (Mbiemri)

Adresa: _____

(Rruga, Numri) (Qyteti) (Shteti)

_____ _____

(Numri i telefonit) (Adresa e postës elektronike - *email*)

3. SHKK-ja mund të përfshijë në kontratë me vullnetin e saj, edhe informacion tjetër shtesë, përveç informacionit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

4. Në procesin e lëvrimit të kredisë për herë të parë ose në momentin e ristrukturimit të saj, SHKK-ja i ofron kredimarrësit:

a) planin e shlyerjeve të kredisë në momentin e lëvrimit të saj dhe në rast ristrukturimi, sipas informacionit që disponohet në atë moment;

b) planin e të gjitha pagesave të paracaktuara dhe të njohura, që kredimarrësi paguan në procesin e marrjes së kredisë dhe gjatë kohëzgjatjes së saj;

c) penalitetet që zbatohen ndaj kredimarrësit dhe shembuj të mënyrës së llogaritjes së tyre.

Neni 26

Të drejtat dhe detyrimet në rastin e shlyerjes (pagesës) së kredisë para afatit të maturimit

1. Kredimarrësi ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, edhe para afatit të maturimit, shlyerje të pjesshme ose të plotë të detyrimeve të tij, të lindura nga kontrata e kredisë. Në këtë rast, SHKK-ja duhet të bëjë reduktim të kostos totale të kredisë. Ky reduktim konsiston në uljen e shumës së interesit dhe shpenzimeve të tjera të aplikueshme për shumën e kryegjësë së shlyer para afatit të maturimit, siç është rënë dakord në kontratën e kredisë për të tilla raste.

2. SHKK-ja ka të drejtën për një kompensim të drejtë dhe objektiv, që nuk mund të tejkalojë në asnjë rast:

i) humbjet financiare të SHKK-së, të cilat duhet të jenë të justifikuara nga kosto të mundshme të lidhura direkt me shlyerjen/et e kredisë para afatit;

ii) 1% (një për qind) të shumës së kredisë së paguar para afatit.

Neni 27

Elementet e kontratës së depozitës

1. SHKK-ja dhe anëtari nënshkruajnë një marrëveshje (kontratë) për çdo depozitë me afat pranë SHKK-së.

2. Në kontratën e depozitave me afat, përveç të dhënave personale të anëtarit, përfshihen:

a) shuma e investuar në depozitën me afat;

b) norma vjetore e interesit;

c) shumat e interesit dhe frekuenca e pagesës së tyre;

d) masa e mbajtjes në burim të tatimit mbi të ardhurat nga interesi;

e) data e maturimit të depozitës;

f) kushtet e zgjedhura nga kredimarrësi për rinovimin e depozitës me afat;

g) kushtet e anulimit (prishjes) para kohe të kontratës; dhe

h) penalitetet e aplikueshme në rastin e anulimit (prishjes) para kohe të kontratës.

3. SHKK-ja duhet të parashikojë në kontratën e depozitës, mënyrën e njoftimit të depozituesit për ndryshimin e kushteve apo afateve të kontratës së nënshkruar, para se të aplikojë ndryshimin.

4. Në rast të ndryshimit të një prej elementeve të treguara në pikën 2 të këtij neni, vetëm për një anëtar ose një grup të kufizuar anëtarësh, SHKK-ja është e detyruar të njoftojë paraprakisht me shkrim anëtarin/ët. Në rast të ndryshimit të një prej elementeve të lartpërmendura të kontratës së depozitës, që prek në mënyrë të njëjtë të gjithë anëtarët si rrjedhojë e politikave të SHKK-së, kjo e fundit është e detyruar të njoftojë paraprakisht secilin prej tyre, sipas mënyrës së përcaktuar në kontratë.

5. SHKK-ja është e detyruar t'i japë anëtarit informacion bazë mbi depozitat e tij, të siguruara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

KREU V

KËRKESAT RAPORTUESE DHE MASAT MBIKËQYRËSE

Neni 28

Raportet financiare

1. SHKK-ja mban llogaritë kontabël dhe përgatit raportet financiare për pasqyrimin e saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat kontabël të gjendjes së saj financiare, mbi baza individuale dhe në rastin e Unioneve, edhe në mënyrë të përmbledhur.

2. Llogaritë kontabël dhe raportet financiare përgatiten në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar në ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

3. SHKK-ja harton politikat dhe procedurat kontabël të brendshme, të miratuara nga këshilli drejtues.

Neni 29
Auditimi ligjor

1. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit, kontrollon dhe vlerëson përputhshmërinë e raporteve financiare të SHKK-së, me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

2. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit, kontrollon dhe vlerëson:

a) llogarinë e humbje-fitimit (pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve);

b) bilancin kontabël;

c) raportin për ndryshimet në kapital;

d) pasqyrën e cash – flow;

e) zbatimin e politikave të fshirjes së zërave të bilancit;

f) raportet e konsoliduara (për Unionin);

g) funksionin e kontrollit të brendshëm (nëse është i aplikueshëm);

h) regjistrimet kontabël;

i) sistemet e informacionit;

j) saktësinë dhe plotësimin e raporteve të paraqitura në Bankën e Shqipërisë;

k) mjaftueshmërinë e procedurave kontabël dhe zbatimin e rregulloreve;

l) shënimet që shoqërojnë raportet financiare.

3. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit, verifikon saktësinë e mbajtjes së llogarive kontabël dhe të regjistrimeve financiare, përfshirë metodat e parashikuara nga Banka e Shqipërisë, si dhe përgatit një raport vjetor, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjendjes financiare të SHKK-së, duke u bazuar në raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga SHKK-ja, në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

4. SHKK-ja emëron një shoqëri auditimi, në rastet kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) numri i anëtarëve të SHKK-së është mesatarisht jo më i vogël se 10,000 (dhjetë mijë) anëtarë, gjatë periudhës kontabël; ose

b) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, tejkalon shumën prej 1 (një) miliardë lekësh.

Neni 30
Raportimi në Bankën e Shqipërisë

1. SHKK-ja raporton në Bankën e Shqipërisë, në periudha tremujore, sipas kërkesave të përcaktuara në "Sistemin raportues për shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre", të miratuar nga Banka e Shqipërisë. Të dhënat raportohen jo më vonë se 50 (pesëdhjetë) ditë pas mbylljes së tremujorit përkatës.

2. Unioni raporton sipas kërkesave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, si dhe për të gjitha SHKK-të anëtare të tij, mbi baza individuale dhe në mënyrë të përmbledhur.

3. SHKK-ja që nuk është anëtare e një Unioni dhe rezulton me shkelje të normave mbikëqyrëse, duhet të raportojë në Bankën e Shqipërisë çdo muaj.

4. Unioni raporton në Bankën e Shqipërisë normat mbikëqyrëse të shoqërive të kursim-kreditit që rezultojnë me shkelje të tyre.

5. SHKK-ja dërgon në Bankën e Shqipërisë, brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, një kopje të raportit vjetor dhe një kopje të opinionit të audituesit ligjor, ose shoqërisë së auditimit, ku pasqyrohet gjendja financiare dhe kontabël, mbi baza individuale dhe në rastin e Unionit, edhe në mënyrë të përmbledhur.

6. Banka e Shqipërisë, në ushtrimin e procesit të saj mbikëqyrës, mund të kërkojë në çdo kohë edhe raportime më të shpeshta nga SHKK-të dhe Unionet.

Neni 31
Regjistri i Kredive

1. SHKK-ja raporton në Bankën e Shqipërisë informacionin e kërkuar nga kjo e fundit, për qëllim të Regjistrit të Kredive, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

2. SHKK-të dhe Unionet e tyre kanë të drejtë të përdorin informacionin e mbajtur në Regjistrin e Kredive, sipas rregullave të përcaktuara në aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

Neni 32
Masat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast të mosplotësimit të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton masat mbikëqyrëse, parandaluese dhe ndëshkimore, të parashikuara në ligjin për SHKK-të.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 33
Dispozitë kalimtare

1. SHKK-të dhe Unionet e licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe që ushtrojnë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, marrin masa që treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit të jetë mbi nivelin e përcaktuar në nenin 9 të kësaj rregulloreje, brenda datës 30 qershor 2018.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, SHKK-të dhe Unionet e licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe që ushtrojnë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, marrin masa për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo rregullore, brenda datës 30 qershor 2017.

3. SHKK-të dhe Unionet e licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe që ushtrojnë veprimtari përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, marrin masa që të kontabilizojnë mbi baza të përllogaritura interesat e kredive dhe të llogaritin fondet rezervë për këto interesa, brenda datës 30 qershor 2021.

4. Kërkesat e parashikuara në këtë rregullore për veprimtarinë e SHKK-ve, zbatohen edhe për Unionin, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

ANEKSI 1

FORMULARI NR. 1/1

ZËRAT E AKTIVIT TË PONDERUARA ME RREZIKUN	Vlera kontabël	Koeficienti i ponderimit	Vlera e ponderuar
1. Aktivet pa rrezik me koeficient ponderimi 0%:		0%	
Arka dhe zërat e ngjashëm me të		0%	
Tituj të qeverisë shqiptare të emetuar në monedhën kombëtare		0%	
Aktive të garantuara me kolateral ose me garanci të ngjashme, si vijon : depozitë ose certifikatë depozite, deri në shumën që garanton ekspozimin; tituj të qeverisë shqiptare, të emetuara në monedhë kombëtare; garanci të patjetërsueshme të qeverisë shqiptare.		0%	
2. Aktive me rrezik të ulët me koeficient ponderimi 20%:		20%	
Të drejta ndaj bankave që veprojnë në Republikën e Shqipërisë		20%	
Të drejta ndaj Unionit të SHKK-së.		20%	
3. Aktive me rrezik të mesëm me koeficient ponderimi 50%:		50%	
Kredi hipotekare dhënë anëtarëve për përmirësimin e kushteve të banimit (për blerjen ose rikonstruksionin e banesës, e cila garantohet me hipotekë)		50%	
Kredi me afat maturimi deri në 12 muaj		50%	
Qira financiare		50%	
4. Aktive me rrezik të lartë, me koeficient ponderimi 100%:		100%	
Kredi të tjera ndaj anëtarëve, përveç atyre të klasifikuara në pikat 1 dhe 3		100%	
Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara		100%	
Aktive të tjera të paklasifikuara sipas pikave 1, 2 dhe 3		100%	
TOTALI I AKTIVEVE TË PONDERUARA ME RREZIKUN			

FORMULARI NR. 1/2

ZËRAT E AKTIVIT JASHTË BILANCIT TË PONDERUARA ME RREZIKUN	Vlera kontabël	Koeficienti i ponderimit	Vlera e ponderuar
1. Zërat jashtë bilancit me rrezik të lartë me koeficient ponderimi 100%:		100%	
Angazhime financimi të dhëna		100%	
Garanci të dhëna		100%	
Tituj të dhënë si garanci për kredi ose rifinancim		100%	
Valutë e blerë me afat		100%	
Shuma për t'u marrë në lekë kundrejt shitjes së valutave		100%	
Angazhime të tjera		100%	
TOTALI I ZËRAVE JASHTË BILANCIT TË PONDERUARA ME RREZIKUN			

FORMULARI NR. 1/3

Kodi	RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT	
1	Totali i zërave të aktivit të ponderuara me rrezikun	
2	Totali i zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun	
3	**Totali i aktiveve dhe zërave jashtë bilancit të ponderuara me rrezikun (1+2)**	
4	Kapitali i SHKK-së	
5	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (4/3)*100	
6	Raporti minimal i mjaftueshmërisë së kapitalit	12%

VENDIM
Nr. 106, datë 5.10.2016

PËR MIRATIMIN E "SISTEMIT RAPORTUES PËR SHOQËRITË E KURSIM-KREDITIT DHE UNIONET E TYRE"

Në bazë dhe për zbatim të pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre" dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes dhe të Departamentit të Statistikave Financiare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë Sistemin Raportues për Shoqëritë e kursim-kreditit dhe Unionet e tyre, sipas formularëve bashkëlidhur dhe të përcaktuar si më poshtë:

a) Raportimet nga Unionet për aktivitetin e tyre, sipas këtyre formularëve:

- Formulari nr. 1: Aktivet
- Formulari nr. 2: Pasivet
- Formulari nr. 3: Llogaria fitim-humbje
- Formulari nr. 4: Zërat jashtë bilancit
- Formulari nr. 5: Kreditë e klasifikuara sipas kalimit të afatit të kthimit
- Formulari nr. 6: Klasifikimi i kredive dhe llogaritja e provigjioneve
- Formulari nr. 6/1: Klasifikimi i linjave të kredisë për anëtarët
- Formulari nr. 7: Cilësia e portofolit të kredisë
- Formulari nr. 8: Depozitat sipas valutës dhe maturimit fillestar
- Formulari nr. 9: Pozicioni në valutë – Aktivi
- Formulari nr. 9/1: Pozicioni në valutë – Pasivi
- Formulari nr. 10: Pozicionet e hapura valutore
- Formulari nr. 11: Kapitali
- Formulari nr. 12: Zërat e aktivit të ponderuar me rrezikun
- Formulari nr. 12/1: Zërat e aktivit jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun
- Formulari nr. 12/2: Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit
- Formulari nr. 13: Ekspozimet e mëdha
- Formulari nr. 14: Rreziku i likuiditetit
- Formulari nr. 14/1: Aktivet sipas maturimit të mbetur
- Formulari nr. 14/2: Pasivet sipas maturimit të mbetur
- Formulari nr. 14/3: Kreditë me afat mbi 5 vjet
- Formulari nr. 14/4: Kreditë me afat mbi 10 vjet
- Formulari nr. 15: Tregues të tjerë
- Formulari nr. 16: Investimi i fondeve

- Formulari nr. 17: Evidenca e kreditit sipas afatit të maturimit
- Formulari nr. 18: Kredia sipas monedhës dhe maturimit
- Formulari nr. 19: Numri i degëve
- Formulari nr. 20: Numri i anëtarëve

b) Raportimet nga Unionet për totalin e shoqërive të kursim-kreditit, sipas këtyre formularëve:
- Formulari nr. 1: Aktivet
- Formulari nr. 2: Pasivet
- Formulari nr. 3: Llogaria fitim-humbje
- Formulari nr. 4: Zërat jashtë bilancit
-Formulari nr. 5: Kreditë e klasifikuara sipas kalimit të afatit të kthimit
- Formulari nr. 6: Klasifikimi i kredive dhe llogaritja e provigjioneve
- Formulari nr. 6/1: Klasifikimi i qirasë financiare dhe llogaritja e provigjioneve
- Formulari nr. 7: Përqendrimi i depozitave
- Formulari nr. 8: Depozitat e anëtarëve rezidentë sipas sektorit, afatit dhe monedhës
- Formulari nr. 9: Huat e dhëna sipas aktivitetit ekonomik dhe cilësisë së portofolit
- Formulari nr. 10: Huat e anëtarëve sipas sektorit, monedhës, afatit dhe qëllimit të përdorimit
- Formulari nr. 11: Kategoritë e kredive të dhëna nga totali i SHKK-ve
- Formulari nr. 12: Portofoli i qirasë financiare
- Formulari nr. 13: Bono thesari të emetuara nga qeveria shqiptare dhe të mbajtura nga SHKK-të
- Formulari nr. 14: Numri i SHKK-ve anëtare të Unionit
- Formulari nr. 15: Numri i anëtarëve të SHKK-ve
- Formulari nr. 16: Të dhëna mbi anëtarët

c) Raportimet nga Unionet me të dhëna individuale për çdo shoqëri kursim-krediti, ose nga vetë SHKK-ja në rastin kur nuk është anëtare e një Unioni, sipas këtyre formularëve:
- Formulari nr. 1: Aktivet
-Formulari nr. 2: Pasivet
- Formulari nr. 3: Llogaria fitim-humbje
- Formulari nr. 4: Zërat jashtë bilancit
- Formulari nr. 5: Kreditë e klasifikuara sipas kalimit të afatit të kthimit
- Formulari nr. 6: Klasifikimi i kredive dhe llogaritja e provigjioneve
- Formulari nr. 6/1: Klasifikimi i qirasë financiare dhe llogaritja e provigjioneve
- Formulari nr. 7: Cilësia e portofolit të kredisë
- Formulari nr. 8: Përqendrimi i depozitave
- Formulari nr. 8/1: Depozita të anëtarëve rezidentë sipas sektorit, afatit dhe monedhës
- Formulari nr. 9: Pozicioni në valutë - Aktivi
- Formulari nr. 9/1: Pozicioni në valutë - Pasivi
- Formulari nr. 10: Pozicionet e hapura valutore
- Formulari nr. 11: Kapitali
- Formulari nr. 12: Zërat e aktivit të ponderuar me rrezikun
- Formulari nr. 12/1: Zërat e aktivit jashtë bilancit të ponderuar me rrezikun
- Formulari nr. 12/2: Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit
- Formulari nr. 13: Ekspozimet e mëdha
- Formulari nr. 14: Rreziku i likuiditetit
- Formulari nr. 14/1: Aktivet sipas maturimit të mbetur
- Formulari nr. 14/2: Pasivet sipas maturimit të mbetur
- Formulari nr. 14/3: Kreditë me afat mbi 5 vjet
- Formulari nr. 14/4: Kreditë me afat mbi 10 vjet
- Formulari nr. 15: Tregues të tjerë
- Formulari nr. 16: Investimi i fondeve
- Formulari nr. 17: Huat e dhëna sipas aktivitetit ekonomik dhe cilësisë së portofolit.
- Formulari nr. 18: Huat e anëtarëve sipas sektorit, monedhës, afatit dhe qëllimit të përdorimit.
- Formulari nr. 19: Evidenca e kreditit sipas afatit të maturitetit
- Formulari nr. 20: Kredia sipas monedhës dhe maturimit
- Formulari nr. 21: Kategoritë e kredive të dhëna nga SHKK-ja
- Formulari nr. 22: Portofoli i qirasë financiare
- Formulari nr. 23: Evidenca e transfertave dhe pagesave
- Formulari nr. 24: Bono thesari të emetuara nga qeveria shqiptare dhe të mbajtura nga SHKK-të
- Formulari nr. 25: Numri i degëve
- Formulari nr. 26: Numri i anëtarëve
- Formulari nr. 27: Të dhëna mbi anëtarët

2. Raportimi i të dhënave sipas formularëve të mësipërm bëhet në periudha tremujore, siç përcaktohet në rregulloren "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre ".

3. Shënimet shpjeguese të formularëve janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Sistemi Raportues i Shoqërive të Kursim-Kreditit, miratuar me vendimin nr. 44, datë 8.6.2005, shfuqizohet.

5. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 30 qershor 2017.

KRYETARI
Gent Sejko

Shënime shpjeguese për plotësimin e formularëve të raportimit nga Unionet

Formulari 1:

- Kodi 1 Veprime thesarin: Ky zë është shuma e zërave 1.1, 1.2, 1.3, dhe 1.4.

- Kodi 1.1 Arka: Arka përfaqëson kartëmonedhat, monedhat metalike dhe çeqet e udhëtarit në lekë dhe në monedha të huaja, të poseduara fizikisht nga institucioni financiar dhe që janë menjëherë të disponueshme.

- Kodi 1.2 Bono thesari: Në këtë zë përfshihet vlera nominale e bonove të thesarit të zotëruara nga Unioni dhe përbëhet nga zërat 1.2.1 (bono thesari), 1.2.2 (skonto/shtesa) dhe 1.2.3 (interesi i përllogaritur).

- Kodi 1.3 Llogari rrjedhëse në banka: përfshijnë llogaritë rrjedhëse që ka Unioni në bankat e nivelit të dytë. Llogaritë rrjedhëse janë të transferueshme dhe i vihen në dispozicion Unionit menjëherë. Ky zë është shumë e zërave 1.3.1 (llogari rrjedhëse në banka) dhe 1.3.2 (interesa të përllogaritur).

- Kodi 1.4 Depozita në banka: Ky zë është shuma e zërave 1.4.1, 1.4.2, dhe 1.4.3.

- Kodi 1.4.1 Depozita pa afat në banka: Ky zë përfshin shumat e depozituara në bankat e nivelit të dytë për të cilat është rënë dakord të kenë një normë interesi dhe një afat maturimi më të vogël se një ditë pune.

- Kodi 1.4.2 Depozita me afat në banka: Ky zë përfshin shumat e depozituara në bankat e nivelit të dytë për të cilat është rënë dakord të kenë një datë shlyerjeje më të madhe se një ditë pune dhe një normë interesi.

- Kodi 1.4.3 Certifikata depozitash: Certifikatat e depozitave përfshijnë certifikatat që Unioni ka blerë nga bankat e nivelit të dytë.

- Kodet 1.4.1.2, 1.4.2.2, dhe 1.4.3.2 Interesi i përllogaritur për depozitat pa dhe me afat, si dhe për certifikatat e depozitave: Interesat e përllogaritura për depozitat pa dhe me afat, si dhe për certifikatat e depozitave, të cilëve nuk u ka ardhur afati i pagimit regjistrohen në këtë llogari sipas zërave përkatës.

- Kodi 2 Veprimet me anëtarët: Ky zë është shuma e zërave 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 2.5 dhe 2.6.

- Kodi 2.1 Hua standarde dhe paradhënie për anëtarët: Ky zë është shuma e zërave 2.1.1 (Hua afatshkurtër), 2.1.2 (Hua afatmesme) dhe 2.1.3 (Hua afatgjatë).

- Kodi 2.2 Hua në ndjekje: Ky zë është shuma e zërave 2.2.1 (Hua afatshkurtër), 2.2.2 (Hua afatmesme) dhe 2.2.3 (Hua afatgjatë).

- Kodi 2.3 Hua nënstandarde: Ky zë është shuma e zërave 2.3.1 (Hua afatshkurtër), 2.3.2 (Hua afatmesme) dhe 2.3.3 (Hua afatgjatë).

- Kodi 2.4 Hua të dyshimta: Ky zë është shuma e zërave 2.4.1 (Hua afatshkurtër), 2.4.2 (Hua afatmesme) dhe 2.4.3 (Hua afatgjatë).

- Kodi 2.5 Hua të humbura: Ky zë është shuma e zërave 2.5.1 (Hua afatshkurtër), 2.5.2 (Hua afatmesme) dhe 2.5.3 (Hua afatgjatë).

- Kodi 2.6 Linja kredie për anëtarët: Ky zë është shuma e zërave 2.6.1[1] (Linja kredie për anëtarët) dhe 2.6.2 (Interesi i përllogaritur).

- Kodi 3 Mjete dhe detyrime të tjera: Ky zë është shuma e zërave 3.1 (Mjete të tjera) dhe 3.2 (Llogari marrëdhëniesh).

- Kodi 3.1 Mjete të tjera: Ky zë është shuma e zërave 3.1.1 (Debitorë të ndryshëm), 3.1.2 (Mjete inventari), 3.1.3 (Fonde rezervë për zhvlerësimin e mjeteve të tjera) dhe 3.1.4 (Të ardhura të llogaritura dhe shpenzime të shtyra).

- Kodi 3.1.1 Debitorë të ndryshëm: Ky zë është shuma e zërave 3.1.1.1 (Kredi tregtare) dhe 3.1.1.2 (Të tjera).

- Kodi 3.1.1.1 Kredi tregtare - është kredia direkte që furnizuesi i mallrave dhe shërbimeve u jep klientëve të tij (llogari të arkëtueshme me

[1] Siç përcaktohet në nenin 13, pikat 5 dhe 6 të rregullores "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të Unioneve të tyre".

furnitorët për blerjen e mallrave dhe/ose shërbimeve).

- Kodi 3.1.2 Mjete inventari: Ky zë është shuma e zërave 3.1.2.1 ku përfshihen toka, ndërtesë dhe mjete të tjera të përftuara nëpërmjet një procesi ligjor) dhe 3.1.2.2 (Të tjera).

- Kodi 4 Mjete të qëndrueshme dhe burimet e përhershme: Ky zë është shuma e zërave 4.1 (Interesa pjesëmarrës), 4.2 (Aktive të qëndrueshme të trupëzuara (neto)), 4.3 (Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara (neto)) dhe 4.4 (Mjete të tjera jofinanciare).

Formulari 2:

- Kodi 1 Llogari rrjedhëse dhe llogari garancie: Ky zë përfshin llogaritë e depozituara në Union, të tilla si llogaritë për kryerjen e transfertave në dobi të një përftuesi të përcaktuar nga anëtari, llogaritë e bllokuara për garanci në pritje të kryerjes së një veprimi të një anëtari etj.

- Kodi 2 Huamarrje: Ky zë është shuma e zërave 2.1 dhe 2.2, dhe përfshin kreditë që Unioni ka marrë nga bankat, institucionet e kreditit, institucionet e tjera financiare, dhe nga qeveria shqiptare e administrata publike.

- Kodi 2.1 Hua marrë nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare: Ky zë është shuma e zërave 2.1.1 (hua pa afat marrë nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare) dhe 2.1.2. (hua me afat marrë nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare), ku përfshihet principali i kredisë së marrë dhe interesi i përllogaritur, të cilit nuk i ka ardhur ende afati i pagimit.

- Kodi 2.2 Hua të marra nga qeveria shqiptare dhe administrata publike: Ky zë përbëhet nga huat e marra nga qeveria qendrore dhe qeveria lokale, ku përfshihet principali i kredisë së marrë dhe interesi i përllogaritur, të cilit nuk i ka ardhur ende afati i pagimit.

- Kodi 2.2.1 Qeveria qendrore - përfshin të gjitha departamentet administrative të shtetit dhe agjencitë qendrore, kompetencat e të cilave shtrihen mbi të gjithë territorin ekonomik të vendit. Të tilla janë ministritë dhe administrata publike qendrore, si dhe organizatat jo me qëllim fitimi të kontrolluara nga qeveria.

- Kodi 2.2.2 Qeveria lokale – përfshin bashkitë dhe pushtetin lokal. Të përfshira në këtë nënsektor janë, gjithashtu, ato institucione jofitimprurëse, të cilat janë të kontrolluara nga pushteti vendor dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre vetëm brenda territorit ekonomik të qeverisë lokale.

- Kodi 3 Veprimet me anëtarët: Ky zë është shuma e zërave 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, dhe 3.5.

- Kodi 3.1 Llogari rrjedhëse: Ky zë përfshin shumat e depozituara në llogari rrjedhëse nga anëtarët në Union.

- Kodi 3.2 Depozita pa afat: Ky zë përfshin depozitat pa afat të anëtarëve në Union.

- Kodi 3.3 Depozita me afat pa interes: Ky zë përfshin shumat e depozituara nga anëtarët në Union, për të cilat nuk paguhet interes.

- Kodi 3.4 Depozita me afat me interes: Ky zë përfshin shumat e depozituara nga anëtarët në Union, për të cilat paguhet interes. Në këtë zë përfshihet dhe interesi i përllogaritur.

- Kodi 3.5 Depozita të bllokuara si garanci për kreditë: Ky zë përfshin depozitat e anëtarëve të bllokuara si garanci për kreditë që marrin pranë Unionit, ku përfshihet dhe interesi i përllogaritur.

- Kodi 4 Mjete dhe detyrime të tjera: Ky zë është shuma e zërave 4.1 (Detyrime të tjera), 4.2 (Llogaritë e marrëdhënieve) dhe 4.3 (Llogari të tjera).

- Kodi 4.1 Detyrime të tjera: Ky zë është shuma e zërave 4.1.1 (Kreditorë të ndryshëm) dhe 4.1.2. (Shpenzime të llogaritura dhe të ardhura të shtyra).

- Kodi 4.1.1 Kreditorë të ndryshëm: Ky zë është shuma e zërave 4.1.1.1 (Kredi tregtare) dhe 4.1.1.2 (Të tjera).

- 4.1.1.1Kredi tregtare - është kredia direkte që furnizuesi i mallrave dhe shërbimeve i jep klientëve të tij (llogari të pagueshme me furnitorët për blerjen e mallrave dhe/ose shërbimeve).

- Kodi 5 Mjete të qëndrueshme dhe burime të përhershme: Ky zë është shuma e zërave 5.1 (Ndihma dhe financimi publik, 5.2 (Fondet rezervë të tjera) dhe 5.3. (Kapitali i Unionit)

- Kodi 5.1 Ndihma dhe financimi publik: Në këtë zë, te pjesa "ndihma" regjistrohet vlera e

tregut[2] e një ndihme të marrë, dhe shërben si kundërparti e mjetit (p.sh. ndërtesë, pajisje, bono thesari, etj.), të cilit i korrespondon kjo ndihmë.

- 5.2 Fondet rezervë të tjera: Në këtë zë mund të përfshihen fondet rezervë për konflikte gjyqësore ose detyrime të paparashikuara, etj.

- Kodi 5.3 Kapitali i Unionit: Ky zë është shuma e zërave: 5.3.1 (Kontributet e anëtarëve), 5.3.2 (Fondet e donatorëve), 5.3.3 (Rezerva ligjore), 5.3.4 (Rezerva statutore), 5.3.5 (Rezerva të tjera), 5.3.6 (Fitim/Humbjet e grumbulluara), 5.3.7 (Rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme), 5.3.8. (Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor).

Rezidenca

Përkufizimi i rezidencës shërben për ndarjen midis sektorëve rezidentë dhe jorezidentë në aktivin dhe pasivin e bilancit.

Rezidenca e çdo njësie institucionale është territori ekonomik me të cilin ka lidhjen më të fortë, i shprehur si qendra dominuese e interesit ekonomik.

Një njësi institucionale është rezidente e një ekonomie, brenda territorit ekonomik të vendit, ku ajo ka një seli, një vend prodhimi ose kryen aktivitete brenda territorit ekonomik të këtij vendi, në të cilin ajo angazhohet dhe do të vazhdojë të angazhohet në aktivitete dhe transaksione ekonomike, në një shkallë të konsiderueshme, për një vit ose më shumë.

Pra, **jorezident** do të konsiderohet çdo individ, ndërmarrje, apo organizatë e vendosur në një vend tjetër jashtë Shqipërisë. Degët dhe filialet e kompanive të huaja në Shqipëri janë rezidentë. Në mënyrë të ngjashme, degët dhe filialet e huaja të kompanive shqiptare janë jorezidentë. Personat, të cilët jetojnë zakonisht (për një periudhë kohore më shumë se një vit) jashtë Shqipërisë, janë gjithashtu jorezidentë. Prandaj emigrantët afatgjatë, konsiderohen jorezidentë të ekonomisë sonë dhe rezidentë në vendet ku punojnë dhe jetojnë. Ndryshe ndodh për personelin ushtarak dhe diplomatik të punësuar në zona si për shembull zonat ushtarake dhe ambasadat. Këto zona janë pjesë e territorit ekonomik të shtetit të tyre dhe punonjësit janë rezidentë, pavarësisht nga kohëzgjatja e punësimit të tyre. Kështu, personelet e huaja të vendosura në ambasadat e akredituara në Shqipëri konsiderohen jorezidentë.

Studentët dhe personat që mjekohen jashtë shtetit trajtohen si rezidentë të ekonomive nga të cilat vijnë, pavarësisht nga kohëqëndrimi i tyre jashtë.

Shënime shpjeguese për plotësimin e formularëve të raportimit nga SHKK-të

Formulari 1:

- Kodi 1 Veprime me thesarin: Ky zë është shuma e zërave 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4.

- Kodi 1.1 Arka: Arka përfaqëson kartëmonedhat, monedhat metalike dhe çeqet e udhëtarit në lekë dhe në monedha të huaja, të poseduara fizikisht nga SHKK-ja dhe që janë menjëherë të disponueshme.

- Kodi 1.2 Bono thesari: Në këtë zë përfshihet vlera nominale e bonove të thesarit të zotëruara nga SHKK-ja dhe përbëhet nga zërat 1.2.1 (bono thesari), 1.2. 2 (skonto/shtesa) dhe 1.2.3 (interesi i përllogaritur).

- Kodi 1.3 Llogari rrjedhëse në banka dhe në Union: Ky zë është shuma e zërave 1.3.1 (Llogari rrjedhëse në banka) dhe 1.3.2 (Llogari rrjedhëse në Union).

- Kodi 1.3.1 Llogari rrjedhëse me bankat: përfshijnë llogaritë rrjedhëse që ka SHKK-ja në bankat e nivelit të dytë. Llogaritë rrjedhëse janë të transferueshme dhe i vihen në dispozicion SHKK-së menjëherë. Ky zë është shumë e zërave 1.3.1.1 (llogari rrjedhëse në banka) dhe 1.3.1.2 (interesi i përllogaritur).

- Kodi 1.3.2 Llogari rrjedhëse në Union: përfshijnë llogaritë rrjedhëse që ka SHKK-ja tek Unioni. Ky zë është shumë e zërave 1.3.2.1 (llogari rrjedhëse në Union) dhe 1.3.2.2 (interesi i përllogaritur).

- Kodi 1.4 Depozita në banka dhe në Union: Ky zë është shuma e zërave 1.4.1, 1.4.2, 1.4.3, 1.4.4 dhe 1.4.5.

- Kodi 1.4.1 Depozita pa afat në banka: Ky zë përfshin shumat e depozituara në bankat e nivelit të dytë për të cilat është rënë dakord të kenë një normë interesi dhe një afat maturimi më të vogël se një ditë pune.

[2] Vlera e tregut në kohën që është marrë ndihma.

- **Kodi 1.4.2 Depozita pa afat në Union:** përfshijnë depozitat pa afat që ka SHKK-ja tek Unioni.

- **Kodi 1.4.3 Depozita me afat në banka:** Ky zë përfshin shumat e depozituara në bankat e nivelit të dytë për të cilat është rënë dakord të kenë një datë shlyerjeje më të madhe se një ditë pune dhe një normë interesi.

- **Kodi 1.4.4 Depozita me afat në Union:** përfshijnë depozitat me afat që ka SHKK-ja tek Unioni.

- **Kodi 1.4.5 Certifikata depozitash:** Certifikatat e depozitave përfshijnë certifikatat që SHKK-ja ka blerë nga bankat e nivelit të dytë.

- **Kodet 1.4.1.2, 1.4.2.2, 1.4.3.2, 1.4.4.2 dhe 1.4.5.2 Interesi i përllogaritur për depozitat me dhe pa afat, si dhe për certifikatat e depozitave:** Interesat e përllogaritura për depozitat me dhe pa afat, si dhe për certifikatat e depozitave, të cilëve nuk u ka ardhur afati i pagimit regjistrohen në këtë llogari sipas zërave përkatës.

- **Kodi 2 Veprimet me anëtarët:** Ky zë është shuma e zërave 2.1, 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5.

- **Kodi 2.1 Hua standarde dhe paradhënie për anëtarët:** Ky zë është shuma e zërave 2.1.1 (Hua afatshkurtër), 2.1.2 (Hua afatmesme), 2.1.3 (Hua afatgjatë), 2.1.4 (Hua për prona të patundshme (hipotekare)) dhe 2.1.5 (Kontratat e qiradhënies financiare).

- **Kodi 2.2 Hua në ndjekje:** Ky zë është shuma e zërave 2.2.1 (Hua afatshkurtër), 2.2.2 (Hua afatmesme), 2.2.3 (Hua afatgjatë), 2.2.4 (Hua për prona të patundshme (hipotekare)) dhe 2.2.5 (Kontratat e qiradhënies financiare).

- **Kodi 2.3 Hua nënstandarde:** Ky zë është shuma e zërave 2.3.1 (Hua afatshkurtër), 2.3.2 (Hua afatmesme), 2.3.3 (Hua afatgjatë), 2.3.4 (Hua për prona të patundshme (hipotekare)) dhe 2.3.5 (Kontratat e qiradhënies financiare).

- **Kodi 2.4 Hua të dyshimta:** Ky zë është shuma e zërave 2.4.1 (Hua afatshkurtër), 2.4.2 (Hua afatmesme), 2.4.3 (Hua afatgjatë), 2.4.4 (Hua për prona të patundshme (hipotekare)) dhe 2.4.5 (Kontratat e qiradhënies financiare).

- **Kodi 2.5 Hua të humbura:** Ky zë është shuma e zërave 2.5.1 (Hua afatshkurtër), 2.5.2 (Hua afatmesme), 2.5.3 (Hua afatgjatë), 2.5.4 (Hua për prona të patundshme (hipotekare)) dhe 2.5.5 (Kontratat e qiradhënies financiare).

- **Kodi 3 Mjete dhe detyrime të tjera:** Ky zë është shuma e zërave 3.1 (Mjete të tjera), 3.2 (Llogari marrëdhëniesh) dhe 3.3 (Tatim mbi vlerën e shtuar).

- **Kodi 3.1 Mjete të tjera:** Ky zë është shuma e zërave 3.1.1 (Debitorë të ndryshëm), 3.1.2 (Mjete inventari), 3.1.3 (Fonde rezervë për zhvlerësimin e mjeteve të tjera) dhe 3.1.4 (Të ardhura të llogaritura dhe shpenzime të shtyra).

- **Kodi 3.1.1.1 Kredi tregtare -** është kredia direkte që furnizuesi i mallrave dhe shërbimeve u jep klientëve të tij (llogari të arkëtueshme me furnitorët për blerjen e mallrave dhe/ose shërbimeve).

- **Kodi 3.1.2 Mjete inventari:** Ky zë është shuma e zërave 3.1.2.1 ku përfshihen toka, ndërtesë dhe mjete të tjera të përftuara nëpërmjet një procesi ligjor) dhe 3.1.2.2 zëri të tjera.

- **Kodi 4 Mjete të qëndrueshme dhe burimet e përhershme:** Ky zë është shuma e zërave 4.1 (Interesa pjesëmarrës), 4.2 (Aktive të qëndrueshme të trupëzuara (neto)), 4.3 (Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara (neto)) dhe 4.4 (Mjete të tjera jofinanciare).

Formulari 2:

- **Kodi 1 Llogari rrjedhëse dhe llogari garancie:** Ky zë përfshin llogari të tilla si: llogaritë për kryerjen e transfertave në dobi të një përfituesi të përcaktuar nga anëtari, llogaritë e bllokuara për garanci në pritje të kryerjes së një veprimi të një anëtari etj.

- **Kodi 2 Huamarrje:** Ky zë është shuma e zërave 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe përfshin kreditë që SHKK-ja ka marrë nga bankat, institucionet e kreditit, institucionet e tjera financiare, Unioni dhe nga qeveria shqiptare e administrata publike.

- **Kodi 2.1 Hua marrë nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare:** Ky zë është shuma e zërave 2.1.1 (hua pa afat marrë nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare) dhe 2.1.2. (hua me afat marrë nga bankat, institucionet e kreditit dhe institucionet e tjera financiare), ku përfshihet principali i kredisë së marrë dhe interesi i përllogaritur, të cilit nuk i ka ardhur ende afati i pagimit.

- **Kodi 2.2 Hua marrë nga Unioni:** Ky zë përbëhet nga huat e marra nga Unioni, ku përfshihet principali i kredisë së marrë dhe interesi i

përllogaritur, të cilit nuk i ka ardhur ende afati i pagimit.

- Kodi 2.3 Hua të marra nga qeveria shqiptare dhe administrata publike: Ky zë është shuma e zërave 2.3.1 (Qeveria qendrore) dhe 2.3.2 (Qeveria lokale), ku përfshihet principali i kredisë së marrë dhe interesi i përllogaritur, të cilit nuk i ka ardhur ende afati i pagimit.

Qeveria Qendrore - përfshin të gjitha departamentet administrative të shtetit dhe agjencitë qendrore, kompetencat e të cilave shtrihen mbi të gjithë territorin ekonomik të vendit. Të tilla janë ministritë dhe administrata publike qendrore, si dhe organizatat jo me qëllim fitimi të kontrolluara nga qeveria.

Qeveria lokale – përfshin bashkitë dhe pushtetin lokal. Të përfshira në këtë nënsektor janë, gjithashtu, edhe ato institucione jofitimprurëse, të cilat janë të kontrolluara nga pushteti vendor dhe që ushtrojnë aktivitetin e tyre vetëm brenda territorit ekonomik të qeverisë lokale.

- Kodi 3 Veprimet me anëtarët: Ky zë është shuma e zërave 3.1, 3.2, 3.3, 3.4 dhe 3.5.

- Kodi 3.1 Llogari rrjedhëse: Ky zë përfshin shumat e vendosura nga anëtarët në SHKK, në formën e llogarive rrjedhëse.

- Kodi 3.2 Depozita pa afat: Ky zë përfshin shumat e vendosura nga anëtarët në SHKK, në formën e depozitave pa afat.

- Kodi 3.3 Depozita me afat pa interes: Ky zë përfshin shumat e depozituara nga anëtarët në SHKK, për të cilat nuk paguhet interes.

- Kodi 3.4 Depozita me afat me interes: Ky zë përfshin shumat e depozituara nga anëtarët në SHKK, për të cilat paguhet interes. Në këtë zë përfshihet dhe interesi i përllogaritur.

- Kodi 3.5 Depozita të bllokuara si garanci për kreditë: Ky zë përfshin depozitat e anëtarëve të bllokuara si garanci për kreditë që marrin pranë SHKK-së, ku përfshihet dhe interesi i përllogaritur.

- Kodi 4 Mjete dhe detyrime të tjera: Ky zë është shuma e zërave 4.1 (Detyrime të tjera), 4.2 (Llogaritë e marrëdhënieve) dhe 4.3 (Llogari të tjera).

- Kodi 4.1 Detyrime të tjera: Ky zë është shuma e zërave 4.1.1 (Kreditorë të ndryshëm) dhe 4.1.2. (Shpenzime të llogaritura dhe të ardhura të shtyra).

- Kodi 4.1.1 Kreditorë të ndryshëm: Ky zë është shuma e zërave 4.1.1.1 (Kredi tregtare) dhe 4.1.1.2 (Të tjera).

- Kodi 4.1.1.1 Kredia tregtare - është kredia direkte që furnizuesi i mallrave dhe shërbimeve i jep klientëve të tij (llogari të pagueshme me furnitorët për blerjen e mallrave dhe/ose shërbimeve).

- Kodi 5 Mjete të qëndrueshme dhe burime të përhershme: Ky zë është shuma e zërave 5.1 (Ndihma dhe financimi publik), 5.2 (Fondet rezervë të tjera) dhe 5.3. (Kapitali i SHKK-së).

- Kodi 5.1 Ndihma dhe financimi publik: Në këtë zë, te pjesa "ndihma" regjistrohet vlera e tregut[3] e një ndihme të marrë, dhe shërben si kundërparti e mjetit (p.sh. ndërtesë, pajisje, bono thesari etj.), të cilit i korrespondon kjo ndihmë.

- 5.2 Fondet rezervë të tjera: Në këtë zë mund të përfshihen fondet rezervë për konfliktet gjyqësore dhe detyrime të paparashikuara etj.

- Kodi 5.3 Kapitali i SHKK-së: Ky zë është shuma e zërave: 5.3.1 (Kontributet e anëtarëve), 5.3.2 (Fondet e donatorëve), 5.3.3 (Rezerva ligjore), 5.3.4 (Rezerva statutore), 5.3.5 (Rezerva të tjera), 5.3.6 (Fitim/Humbjet e grumbulluara), 5.3.7 (Rezerva e rivlerësimit të aktiveve të qëndrueshme), 5.3.8. (Fitimi (humbja) i vitit ushtrimor).

Rezidenca

Përkufizimi i rezidencës shërben për ndarjen midis sektorëve rezidentë dhe jorezidentë në aktivin dhe pasivin e bilancit.

Rezidenca e çdo njësie institucionale është territori ekonomik me të cilin ka lidhjen më të fortë, i shprehur si qendra dominuese e interesit ekonomik.

Një njësi institucionale është rezidente e një ekonomie, brenda territorit ekonomik të vendit, ku ajo ka një seli, një vend prodhimi ose kryen aktivitete brenda territorit ekonomik të këtij vendi, në të cilin ajo angazhohet dhe do të vazhdojë të angazhohet në aktivitete dhe transaksione ekonomike, në një shkallë të konsiderueshme, për një vit ose më shumë.

Pra, **jorezident** do të konsiderohet çdo individ, ndërmarrje apo organizatë e vendosur në një vend tjetër jashtë Shqipërisë. Degët dhe filialet e kompanive të huaja në Shqipëri janë rezidentë. Në mënyrë të ngjashme, degët dhe filialet e huaja të

[3] Vlera e tregut në kohën që është marrë ndihma.

kompanive shqiptare janë jorezidentë. Personat, të cilët jetojnë zakonisht (për një periudhë kohore më shumë se një vit) jashtë Shqipërisë, janë gjithashtu jorezidentë. Prandaj emigrantët afatgjatë konsiderohen jorezidentë të ekonomisë sonë dhe rezidentë në vendet ku punojnë dhe jetojnë. Ndryshe ndodh për personelin ushtarak dhe diplomatik të punësuar në zona si për shembull zonat ushtarake dhe ambasadat. Këto zona janë pjesë e territorit ekonomik të shtetit të tyre dhe punonjësit janë rezidentë, pavarësisht nga kohëzgjatja e punësimit të tyre. Kështu, personelet e huaja të vendosura në ambasadat e akredituara në Shqipëri konsiderohen jorezidentë.

Studentët dhe personat që mjekohen jashtë shtetit trajtohen si rezidentë të ekonomive nga të cilat vijnë, pavarësisht nga kohëqëndrimi i tyre jashtë.

Formulari 8/1, raportimi për SHKK-të (**Formulari 8**, raportimi për totalin e SHKK-ve): "Depozita të anëtarëve rezidentë sipas sektorit, afatit dhe monedhës"

Totali i depozitave në këtë formular duhet të jetë i barabartë me totalin e depozitave të anëtarëve të raportuara në klasën 3 "Veprime me anëtarët" të pasivit të bilancit.

Anëtarët në këtë formular klasifikohen sipas sektorëve në:

- Korporata jofinanciare private;
- Individët;
- Institucionet jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve.

Përkufizimi i sektorëve në këtë formular është si në udhëzimin për formularin "*Huat e anëtarëve sipas sektorit, monedhës, afatit dhe qëllimit të përdorimit.*"

Llogaritë rrjedhëse në këtë formular duhet të jenë të barabarta me llogaritë rrjedhëse të raportuara në pasiv të bilancit, klasa 3, zëri 3.1 "Llogari rrjedhëse".

Depozita pa afat në këtë formular duhet të jenë të barabarta me depozitat pa afat të raportuara në pasiv të bilancit, klasa 3, zëri 3.2 "Depozita pa afat".

Depozita me afat sipas maturitetit origjinal (fillestar) në këtë formular duhet të jenë të barabarta me depozitat me afat me interes dhe depozitat me afat *pa interes* nga anëtarët, të raportuara në pasiv të bilancit, klasa 3, zërat: 3.3 "Depozita me afat pa interes" + 3.4 "Depozita me afat me interes".

Depozita të bllokuara si garanci për kreditë në këtë formular duhet të jenë të barabarta me depozitat e bllokuara si garanci për kreditë e raportuara në pasiv të bilancit, klasa 3, zëri: 3.5 "Depozita të bllokuara si garanci për kreditë".

Formulari 17, raportimi për SHKK-të (**Formulari 9**, raportimi për totalin e SHKK-ve): ***"Huat e dhëna sipas aktivitetit ekonomik dhe cilësisë së portofolit"***

Teprica e huave në fund të periudhës" që raportohet në këtë formular duhet të jetë e barabartë me huat e raportuara në klasën 2 "Veprimet me anëtarët" në aktivin e bilancit.

Për huan në zërat 1 dhe 2 në këtë formular përkufizimi i sektorëve është si në udhëzimin për formularin "*Huat e anëtarëve sipas sektorit, monedhës, afatit dhe qëllimit të përdorimit.*"

Huaja në këtë formular ndahet sipas aktivitetit ekonomik që kryejnë anëtarët. Klasifikimi i aktivitetit ekonomik në këto grupe mbështetet në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike Rev. 2.2, (hartuar nga INSTAT-i, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave) si më poshtë:

A Bujqësia, pyjet, peshkimi
B Industria nxjerrëse
C Industria përpunuese
D Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar
E Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
F Ndërtimi
G Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave
H Transporti dhe magazinimi
I Akomodimi dhe shërbimi ushqimor
J Informacioni dhe komunikacioni
K Aktivitete financiare dhe të sigurimit
L Aktivitete të pasurive të paluajtshme
M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
N Shërbime administrative dhe mbështetëse
O Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm
P Arsimi
Q Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale
R Arte, argëtim dhe çlodhje

S Aktivitete të tjera shërbimi

T Aktivitete të familjeve si punëdhënës; Aktivitete të prodhimit të mallrave e shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorimin e vet

U Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare

Zërat 1 dhe 2, duhet të jenë të barabartë me totalin e nënzërave nga zëri A në zërin U.

Formulari 18, raportimi për SHKK-të (**Formulari 10**, raportimi për totalin e SHKK-ve**):** ***"Huat e anëtarëve sipas sektorit, monedhës, afatit dhe qëllimit të përdorimit."***

"Teprica e huave në fund të periudhës" që raportohet në këtë formular, duhet të jetë e barabartë me huat e raportuara në klasën 2 "Veprimet me anëtarët" në aktivin e bilancit.

Për qëllime të këtij formulari, **anëtarët** klasifikohen në sektorët dhe nënsektorët e ekonomisë si më poshtë:

- Korporatat jofinanciare private – përfshijnë të gjitha shoqëritë tregtare private (jofinanciare) ose bizneset private, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". *Përjashtim bëjnë vetëm personat fizikë*, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me nenin 1 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe që klasifikohen në sektorin *"Individët" (Ekonomitë familjare).*

Huaja për këtë sektor detajohet gjithashtu, edhe sipas madhësisë së biznesit.

Madhësia e biznesit, përcaktohet në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 10042, datë 22.12.2008. Në përputhje me ligjin e sipërcituar, korporatat jofinanciare private klasifikohen në:

a) mikrondërmarrje (mikrobiznes): ku përfshihen ndërmarrjet, të cilat kanë të punësuar më pak se 10 persona dhe një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë;

b) biznes i vogël: ku përfshihen ndërmarrjet, të cilat kanë të punësuar 10 deri 49 persona dhe një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor më të madh se 10 milionë lekë dhe më të vogël se 50 milionë lekë;

c) biznes i mesëm: ku përfshihen ndërmarrjet, të cilat kanë të punësuar 50 deri 249 persona dhe një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor nga 50 milionë deri në 250 milionë lekë;

- Individët (Ekonomitë familjare) – përfshijnë individë dhe grupe individësh të cilët janë kryesisht konsumatorë. Ata ndajnë të njëjtën banesë, mbledhin një pjesë ose të gjitha të ardhurat dhe konsumojnë kolektivisht mallrat dhe shërbimet.

